



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafit 1.1 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt.25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**  
**POLICISË SË KOSOVËS**

- I.** Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Policisë së Kosovës, pa procedurë të rregullt të konkurrimit.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: pjesën e parcelës kadastrale nr. 220-1, ZK Prishtinë, me sipërfaqe prej 1977 m<sup>2</sup>, pasuri shoqërore, Kuvendi komunal Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ndërtimi i Stacionit Policor “Veriu” në lagjen “Kodrën e Trimave” në Prishtinë.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, për 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.



**IX.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skicat grafike dhe
- kopja e planit dhe certifikata e pronësisë.

**X.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-463/01-0263726/18, më 01.11.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

